



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 155

Tiranë – E Enjte, 9 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 1.10.2014	Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale.....	7981
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1128/6, datë 2.10.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (lotet 1 dhe 3, kulturat bujqësore dhe drufrutorë).....	7998
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3842/5, datë 19.9.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Shkodër”.....	8004
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3943/3, datë 2.10.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (shtesa).....	8007
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4860/3, datë 2.10.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive, të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ruga Transballkanike”, Vlorë.....	8012
Kërkesë e Ministrisë së Kulturës nr. 4451, datë 1.10.2014	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””.....	8013

**VENDIM****Nr. 634, datë 1.10.2014****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE
SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN,
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
REHABILITIMIN E RRUGËVE
NACIONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pikat 1, shkronja “j” dhe 2, dhe 49, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënie me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, kur ato paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet, qendrore dhe vendore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLAT
PËR VLERËSIMIN DHE DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT TË PUNËVE PUBLIKE DHE
SHËRBIMEVE PËR NDËRTIMIN,
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE
REHABILITIMIN E RRUGËVE
NACIONALE**KREU I****DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi dhe objekti**

Këto rregulla përcaktojnë veprimet përgatitore për dhënie e një kontrate me koncesion/partneritet publik privat, vlerësimin e

pranueshmërisë, përmbajtjes dhe trajtimit të propozimeve të pakërkuara, si dhe procedurën dhe kriteret për vlerësimin dhe miratimin e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat që kërkojnë mbështetje financiare të punëve publike, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, kur ato paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit.

Neni 2**Kufijtë monetarë**

Për qëllime të zbatimit të këtyre rregullave, kufiri i ulët monetar është 5 milionë lekë.

KREU II**RREGULLA TË VEPRIMEVE**
PËRGATITORE TË DHËNIES ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK
PRIVAT**Neni 3****Studime paraprake**

1. Para fillimit të një procedure për dhënie e një kontrate me koncesion/partneritet publik privat, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, në rolin e saj si autoritet kontraktues, kryen veprimet paraprake të parashikuara në nenin 16, pika 3, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

2. Pikënisja e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit/partneritetit publik privat mund të jetë:

a) procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori, duke përcaktuar rrugët nacionale që paraqesin rëndësi të veçantë për infrastrukturën rrugore të vendit;

b) analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit për rrugët nacionale të përcaktuara me rëndësi të veçantë; ose

c) projekt-ide të nxitura nga prioritetet e politikave.

3. Si fazë të parë të studimit të fizibilitetit, autoriteti kontraktues përgatit studimin paraprak, i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit. Ai duhet të përmbajë të paktën, sa më poshtë vijon:



a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore apo të hapësirave të zhvillimit, kontekstin e përmirësimit dhe, nëse është e përshtatshme, një pasqyrë të tregut;

b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;

c) përshkrimin e përgjithshëm të projektit;

ç) legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit;

d) në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërish ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private;

dh) në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërish një subjekt privat;

e) përfitimet strategjike dhe operationale që priten nga projekti;

ë) bashkërendimin me politikat e përgjithshme të investimeve, sektoriale apo rajonale;

f) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;

g) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;

gj) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion;

h) alternativat e alokimit të riskut financiar, teknike dhe operationale ndërmjet palës publike dhe subjektit privat;

i) konkluzionet dhe rekomandimet e zbatimit të mundshëm dhe rregullimet operationale për projektin/projektet e mundshme, duke përfshirë modelet e zbatueshme/të përshtatshme të partneritetit publik privat.

4. Autoriteti kontraktues, bazuar në informacionin, konkluzionet, si dhe rekomandimet e siguruar nga dokumenti i studimit paraprak, mund të vendosë:

a) të ndërpresë studimin dhe të shtyjë ose të refuzojë plotësisht zbatimin e projektit. Bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit/alternativave që janë analizuar. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të

përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit mbi mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare, apo të konkluzionit se objekti, në përgjithësi, nuk është i nevojshëm; ose

b) të vazhdojë me përgatitjen e studimit të fizibilitetit.

5. Në çdo rast, për projektet e koncesioneve / PPP, autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave para se të kalojë në fazën e ardhshme, domethënë në studimin e fizibilitetit. Njoftimi ka qëllimin e vetëm për të mbajtur të informuar Ministrinë e Financave në lidhje me ndikimin e mundshëm buxhetor dhe nuk nënkupton një miratim të veçantë nga Ministria në këtë fazë.

Neni 4

Studimi i fizibilitetit

1. Autoriteti kontraktues harton studimin e fizibilitetit përpara se të ndërmarrë angazhim për realizimin e projektit. Studimi i fizibilitetit siguron shqyrtimin dhe vlerësimin e aspekteve teknike, ekonomike dhe tregtare të një projekti të propozuar, të cilat do të jenë baza për vendimin e investimit.

2. Faza e dytë e studimit të fizibilitetit do të detajojë informacionin e përfshirë në studimin paraprak dhe përmban veçoritë kryesore të projektit, bazuar në analizën teknike, ekonomike dhe financiare, si dhe analizën e ndikimit mjedisor dhe social, që kryhen në funksion të investimit të planifikuar.

3. Faza e fundit e studimit të fizibilitetit do të fokusohet në analizimin e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion/PPP është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

4. Në rastet kur autoriteti kontraktues e gjykon të nevojshme, kërkon bashkëpunim me Njësinë e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat.

Neni 5

Analiza teknike

1. Analiza teknike është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe ka si objektiv kryesor të demonstrojë se projekti mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa risqe të paarsyeshme teknike.



2. Analiza teknike duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm, në masën sa është i mundshëm dhe i zbatueshëm:

a) fondin e projektit.

- iniciatorin e projektit;

- historinë e shkurtër të projektit;

- studimet e kryera tashmë, të tilla si: studimet e parainvestimeve, studimet mbështetëse, hulumtimet, rilevimet e trojeve;

- konceptin e projektit dhe objektivat kryesore;

- përfituesit e projektit;

b) vendndodhjen dhe truallin.

- vendndodhjen dhe, nëse është rasti, listën e alternativave të mundshme të trojeve;

- sipërfaqen totale që do të zihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të përkohshme;

- statusin ligjor të tokës që do të zihet;

- pasuritë e tjera publike, të cilat do të përdoren, nëse ka ndonjë të tillë;

c) kushtet lokale.

- klima dhe fenomenet natyrore specifike për zonën;

- topografinë (duhen bashkëlidhur studimet topografike);

- gjeologjinë dhe seismicitetin (duhen bashkëlidhur studimet/raportet gjeoteknike me rekomandime për themelet);

- gjendja aktuale e rrjetit dhe e lidhjes së shërbimeve;

- disponueshmëria e rrugëve hyrëse, nëse ka ndonjë të tillë;

ç) përshkrimin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit. Ky seksion siguron kryesisht rezultatet që pritet të arrihen dhe nuk përshkruan në mënyrë të detajuar se si do të arrihen.

- përshkrimin e punëve kryesore civile që do të realizohen;

- metodat e ndërtimit;

- teknologjinë dhe pajisjet, të cilat mendohen të përdoren;

- parametrat kryesorë të projektit, si: kapacitetet, sipërfaqet, volumet, gjatësitë dhe tregues të tjerë të veçantë;

- listën e standardeve teknike përkatëse që do të vëzhgohen;

d) periudha e vlerësuar e ndërtimit (në muaj).

3. Sa herë që jepen punime civile për t'u realizuar, analiza teknike duhet të përmbajë, në masën sa janë të mundshme, pjesët përkatëse të skicuara, si vijon:

a) planin e vendndodhjes së zonës (1:25000 - 1:5000);

b) planin e përgjithshëm (1: 2000 - 1:500);

c) planet e përgjithshme dhe seksionet e arkitekturës, rezistencës, instalimeve;

ç) planet e veçanta, profilet gjatësore, profilet tërthore, sipas kërkesës.

Pavarësisht sa më sipër, në rastet e sipërmarrjeve “projektim-zbatim”, operatorët ekonomikë, gjatë apo pas përfundimit të procedurave të tenderit, mund të bëjnë ndryshime në projekte me miratimin e autoritetit kontraktues.

Neni 6

Ndikimet mjedisore dhe sociale

1. Përveç trajtimit të argumentimit ekonomik, studimi i fizibilitetit përcakton ndikimin mjedisor dhe social të projektit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Studimi identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë, por që nuk kufizohen vetëm te popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht. Ai duhet të tregojë, gjithashtu, edhe masat parandaluese që duhen ndërmarrë për të siguruar përputhjen me standardet e BE-së për mjedisin.

3. Studimi merr parasysh aspektet sociale, të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe e shëndetit të komuniteteve, siguria, çështjet e punës dhe, nëse është rasti, ndikimet mbi grupet e pafavorizuara ose në nevojë, blerja e tokës dhe risistemimi i pavullnetshëm, mbrojtja e pasurisë kulturore dhe trashëgimisë.

Neni 7

Analiza ekonomike dhe financiare

1. Analiza ekonomike dhe financiare është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe objektivi i saj kryesor është të përcaktojë “vlerën e parasë” së projektit.

2. Studimi i fizibilitetit shpreh një vlerësim të investimit në total, kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe çdo të ardhur që pritet të krijohet, në të gjithë kohëzgjatjen e projektit.

3. Kostot e drejtpërdrejta të investimeve lidhen në mënyrë specifike me ndërtimin e objekteve të reja dhe mund të përmbajnë, por nuk kufizohen në shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit,



duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, teknike dhe të menaxhimit të projektit, kostot e projektimit, kostot e tokës apo të blerjes së një aseti të ri, kostot e përgatitjes së trullit, kostot e ndërtimeve dhe të vënies në funksionim, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera.

4. Kostot e drejtpërdrejta të mirëmbajtjes përfshijnë kostot e mbajtjes së aseteve gjatë ciklit të plotë të projektit në gjendjen e kërkuar për të dhënë rezultatet e specifikuara dhe mund të përfshijnë kostot e lëndëve të para, mjetet dhe pajisjet, si dhe kostot e personelit të shoqëruara me mirëmbajtjen.

5. Kostot e drejtpërdrejta operative lidhen me funksionimin e përditshëm të objektit dhe përfshijnë koston e plotë të personelit (ku futen pagat, përfitimet e punonjësve, detyrimet për kontributet e pensioneve, kontributet e sigurimeve, trajnimin dhe zhvillimin, pushimet vjetore, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të pritshme shtesë), kostot e shërbimeve, lëndët e para dhe materialet e konsumit, kostot e drejtpërdrejta të menaxhimit, si dhe shpenzimet e sigurimit.

6. Kostot indirekte të projektit janë një pjesë e kostonë së administrimit të objektit dhe përfshijnë kostot e kohës dhe të punës së drejtuesve të lartë, personelit, kontabilitetit, faturimit, shërbimeve ligjore, qirasë, komunikimet dhe burime të tjera institucionale të shfrytëzuara nga projekti.

7. Të ardhurat e projektit përfitohen nga:

a) përdoruesit fundorë që paguajnë për shërbimin apo për një pjesë të tij; dhe/ose

b) përdorimi i aseteve të institucionit.

8. Realizueshmëria ekonomike e projektit do të pasqyrohet nga tregues të ndryshëm të performancës financiare, të tillë si: fluksi i arkës (*Cash-Flow*), vlera aktuale neto (NPV), norma e brendshme e kthimit (IRR), periudha e vetëshlyerjes (PBP) dhe analiza kosto-përfitim (CBA).

9. Përballueshmëria tregon nëse të ardhurat e përgjithshme të projektit janë brenda mundësisë së përdoruesve dhe autoritetit kontraktor, ose e të dyve, për të paguar tarifat dhe/ose tarifat e shërbimeve për objektin që do të jenë rezultat i projektit. Kjo përfshin kontrollimin e kostonë fiskale të projektit si në aspektin e pagesave të rregullta, ashtu edhe në atë të riskut fiskal, si dhe

përcaktimin nëse kjo mund të rregullohet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale.

10. Përshtatshmëria financiare tregon nëse projekti ka gjasa të jetë në gjendje të tërheqë garantues/mbështetje financiare dhe huadhënës cilësorë, duke siguruar rikthim të fortë dhe të arsyeshëm financiar.

11. Realizohet një analizë cilësore dhe/ose sasiore risku në mënyrë që të identifikohet dhe të vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin. Ky informacion përdoret për zhvillimin e strategjive për menaxhimin e riskut dhe do të jetë një bazë e mirë për alokimin e risqeve midis partnerëve publikë dhe privatë. Gjatë analizës mund të merren parasysh kategoritë e mëposhtme të risqeve, por jo vetëm:

a) risqet e trojeve: lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e vendndodhjes së projektit, të tilla si: kostoja dhe koha e marrjes së trullit, lejet e nevojshme ose sigurimi i së drejtës së kalimit për një rrugë, efekti i kushteve gjeologjike ose i kushteve të tjera të trullit, dhe kostoja e plotësimit të standardeve mjedisore;

b) risqet e projektimit, të ndërtimit dhe të vënies në punë: lidhen me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë se sa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se aseti nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit;

c) risqet e funksionimit: lidhen me suksesin e operacioneve, duke përfshirë riskun e ndërprerjes së shërbimit ose të disponueshmërisë së aseteve, riskun që ndonjë ndërveprim rrjeti nuk punon siç pritej, ose që kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes së objektit është e ndryshme nga sa pritej;

ç) risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregtare: lidhen me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej, ose që të ardhurat nuk janë mbledhur siç pritej;

d) risqet ekonomike ose financiare: lidhen me ndryshimet në normat e interesit, kurset e këmbimit ose inflacionit që ndikojë negativisht në rezultatet e projektit;

dh) risqet e pronësisë së aseteve: risqet që lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia vjetrohet ose që vlera e aseteve në fund të kontratës është e ndryshme nga sa pritej;



e) risqet politike: lidhen me vendimet politike, që mund të ndikojnë negativisht mbi projektin;

ë) risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor: risku që një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në tatimet e përgjithshme të korporatave ose në rregullat që rregullojnë këmbimin e monedhës, ose riatdhesimin e fitimeve;

f) risqet e forcës madhore: risqet që lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.

12. Analiza e ndjeshmërisë paraqet informacionin në një mënyrë që lejon të kuptohet saktësisht se çfarë është duke u supozuar si kusht bazë, dhe se si rezultatet përfundimtare do të ndikoheshin nga ndryshimet në supozime të tilla. Kjo është arritur nëpërmjet kryerjes së testeve të ndryshme të ndjeshmërisë dhe nëpërmjet krahasimit të rezultateve me ato që bazohen në supozime të ndryshme për kushtin bazë që rezulton në të paktën tri variacione të fizibilitetit, në veçanti kur të ardhurat e projektit nxirren nga përdoruesit.

Neni 8

Arsyetimi i vendimit të koncesionit/PPP-së

1. Bazuar në rezultatet paraprake të analizës së ndërmarrë në përputhje me nenet 3 deri në 7 të këtyre rregullave, autoriteti kontraktues vendos:

a) nëse është konfirmuar leverdishmëria dhe qëndrueshmëria e projektit; dhe

b) nëse forma koncesion/PPP duket si model i përshtatshëm për zbatimin e projektit.

2. Në rastin kur përgjigjet për të dyja çështjet e parashikuara në pikën 1 janë pozitive, studimi i fizibilitetit vazhdon me arsyetimin e vendimit të koncesionit/PPP-së.

3. Arsyetimi i vendimit të koncesionit/PPP-së kryhet duke filluar me analizën e vlerës së parasë, e cila do të realizohet duke ndjekur modelin cilësor apo sasior. Autoriteti kontraktues do të zgjedhë se cilin prej modeleve do të zbatojë në secilin projekt, duke u bazuar, ndërmjet të tjerash, mbi disponueshmërinë e të dhënave historike dhe ato aktuale të lidhura me projektin, nëse projekti në fjalë apo projekte të ngjashme të të njëjtit sektor infrastrukturor janë administruar

nga sektori publik, në përputhje me metodën “shfrytëzim gjatë tërë ciklit të plotë”, dhe nëse supozimet që duhen bërë si pjesë e metodës sasimore, rezultojnë të besueshme.

4. Analizat cilësore të vlerës së parasë, duhet që, së paku, t'i japin përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

a) Nëse programi i investimeve të kapitalit është shumë i madh dhe kërkon një administrim efektiv të risqeve që shoqërojnë ndërtimin dhe dorëzimin e infrastrukturës.

b) Nëse sektori privat ka ekspertizën e nevojshme për të ofruar dhe nëse ka arsye bindëse se ai do të ofrojë vlerën e parasë.

c) Nëse është e përshtatshme struktura e shërbimit, e cila i lejon sektorit publik të përcaktojë nevojat e veta si produkte nga shërbimet të cilat, në mënyrë të menjëhershme mund të kontraktohen në një mënyrë të tillë që sigurojnë shërbim publik afatgjatë, efektiv, të njëjtë dhe të përgjegjshëm, dhe ku ndarja e riskut ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë është lehtësisht e mundshme dhe e zbatueshme.

ç) Nëse natyra e aseteve dhe shërbimeve të identifikuar si pjesë e skemës së PPP-së, mundëson përlllogaritjen e kostos përgjatë gjithë jetës mbi baza afatgjata.

d) Nëse vlera e projektit është mjaftueshmërisht e madhe që të sigurojë se kostot e prokurimit nuk janë të shpërpjesëtuara.

dh) Nëse teknologjitë apo aspekte të tjera të industrisë përkatëse janë të qëndrueshme dhe nuk kërcënohen nga ndryshimet e menjëhershme.

e) Nëse planifikimet kohore afatgjata janë të tilla që mundësojnë përdorimin e aseteve përtej afateve të gjata në të ardhmen.

ë) Nëse sektori privat ka lehtësira të mëdha që mundësojnë arritjet e tij.

5. Analiza sasimore e vlerës së parasë duhet të ndërmerret duke ndjekur metodologjinë e Krahasuesit të Sektorit Publik (KSP). Ajo fillon me përgatitjen e referencave të projektit, të cilat përfshijnë përlllogaritjen e vlerës neto aktuale, të kostove totale neto të projektit, sikur ajo të ishte prokuruar mbi bazën e prokurimit publik tradicional. Krahasuesi i Sektorit Publik është i përbërë nga flukset e mjeteve monetare që lidhen me:

a) krahasuesin bazë të sektorit publik, i cili paraqet shpenzimet totale të parashikuara në paragrafët 3-6 të nenit 7 të këtyre rregullave,



minus vlerën e të ardhurave që mund të mblidhen, siç është parashikuar në paragrafin 7 të nenit 7;

b) përshtatjen e neutralitetit konkurrues, e cila përfaqëson avantazh konkurrues neto, që i shkon sektorit publik në saje të statusit të tij; dhe

c) përshtatjen e risqeve specifike të projektit, në varësi të alokimit të riskut mes palëve publike dhe private.

Të gjitha flukset monetare të ardhshme të projektit shndërrohen në një kosto aktuale neto nëpërmjet zbatimit të normës së duhur të skontimit.

6. Si rregull i përgjithshëm, alokimi i riskut merr në konsideratë parimin se pala, e cila do të mbajë riskun, është ajo, e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij. Mund të përdoren tri llojet e alokimeve të riskut, si më poshtë:

a) risku i mbajtur - risqet që do të mbahen nga autoriteti kontraktues;

b) risku i transferueshëm - risqet që do të transferohen te partneri privat;

c) risku i përbashkët - risqet që do të mbajnë të dyja palët, siç është rënë dakord në kontratë.

7. Alokimi i riskut do të përdoret, gjithashtu, si një mjet themelor për të cilësuar nëse koncesioni/PPP është klasifikuar si “brenda” ose “jashtë” bilancit të qeverisë, në bazë të rregullave të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA95), sipas mënyrës së kombinimit të alokimeve të tri llojeve të mëposhtme të risqeve:

a) risku i ndërtimit;

b) risku i disponueshmërisë;

c) risku i kërkesës.

8. Nëse krahasimi mes alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e dytë ka potencial të ofrojë vlerën më të mirë të parasë, autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP. Në qoftë se krahasimi midis alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e dytë nuk ka potencial të ofrojë vlerën më të mirë të parasë, atëherë autoriteti kontraktues rishqyrton mundësinë për të realizuar projektin duke përdorur alternativën e prokurimit publik.

9. Shqyrtimi përfundimtar i të gjitha kërkesave ligjore për zbatimin e projektit bëhet së bashku

me një vlerësim të kapacitetit të brendshëm të institucionit zbatues dhe të institucioneve të tjera që ndërmarrin detyra të ndryshme që lidhen me zhvillimin e projektit.

Neni 9

Rezultatet e studimit të fizibilitetit

1. Në thelb, rezultatet e studimit të fizibilitetit duhet të tregojnë se:

a) projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktues;

b) projekti është i realizueshëm, në aspektin e realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;

c) ndikimet negative sociale dhe mjedisore të projektit mund të minimizohen në mënyrë efektive;

ç) alternativa përmes së cilës është parashikuar të përfundojë projekti nëpërmjet dhënies së një kontrate me koncesion/PPP është më e dobishme në krahasim me alternativën e dhënies së një kontrate prokurimi publik.

2. Paraqitja e studimit të fizibilitetit bëhet sipas formularit standard, i cili është pjesë përbërëse e dokumenteve standarde të koncesioneve/PPP-ve.

3. Vetëm projekti që përmbush të gjitha kushtet e pikës 1 të këtij neni, mund të vijojë me shpalljen e procedurës së dhënies me koncesion/PPP, ose të paraqitet për miratim në Ministrinë e Financave, nëse një miratim i tillë është i nevojshëm, në përputhje me nenin 42, të ligjit 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

KREU III

VLERËSIMI I PRANUESHMËRISË, PËRMBAJTJES DHE TRAJTIMIT TË PROPOZIMEVE TË PAKËRKUARA

Neni 10

Rregullat e përgjithshme për paraqitjen e propozimeve të pakërkua

1. Çdo operator ekonomik ose grup operatorësh ekonomikë, referuar më poshtë si propozuesi, mund të paraqesë një propozim të pakërkuar për zbatimin e një projekti koncesionar/PPP dhe autoriteti kontraktues i analizon propozimet e tilla, me kusht që:



a) propozimi të lidhet me një projekt për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale;

b) propozimi nuk lidhet me një projekt, për të cilin tashmë ka filluar ose është shpallur procedura për dhënien e tij.

2. Propozimi i pakërkuar i dorëzohet vetëm autoritetit kontraktues, të cilit ligji i jep autoritetin të ndërmarrë procedurën e dhënies së asaj kontrate të koncesionit/PPP-së.

3. Propozimi i pakërkuar mund të detajohet, në mënyrë që të trajtojë projektin në secilën prej formave të mëposhtme:

a) forma minimale, siç parashikohet në nenin 11 të këtyre rregullave;

b) forma minimale dhe analiza gjithëpërfshirëse teknike, ekonomike dhe financiare;

c) një studim fizibiliteti i zhvilluar plotësisht, duke përfshirë arsyetimin e vendimit për dhënien me koncesion/PPP.

Neni 11

Propozimi i pakërkuar në formë minimale

1. Propozimi i pakërkuar, i paraqitur në këtë formë, përmban të paktën informacionin që përcakton projektin në një nivel të përgjithshëm dhe që lejon autoritetin kontraktues që të bëjë një vlerësim paraprak të aspekteve të domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë, si dhe nëse propozimi duket të jetë i realizueshëm dhe në interes të publikut apo jo.

2. Propozimi i pakërkuar, sipas përcaktimit në pikën 1, përmban të paktën sa vijon:

a) përshkrimin e situatës aktuale, vlerësimin e të metave kryesore, kontekstin e zhvillimit dhe, nëse është e përshtatshme, një panoramë të tregut;

b) parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;

c) përshkrim të përgjithshëm të projektit;

ç) përfitimet strategjike dhe operacionale që priten nga projekt;

d) bashkërendimin me politikat e investimeve të përgjithshme, sektoriale apo rajonale;

dh) skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;

e) vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;

ë) analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike;

f) alternativat e alokimit të risqeve financiare, teknike dhe operacionale ndërmjet palës publike dhe palës private.

Neni 12

Vlerësimi paraprak

1. Faza e parë e vlerësimit paraprak është për të verifikuar nëse kushtet e parashikuara në nenin 10 janë plotësuar apo jo dhe se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me pikën 2 të nenit 11 të këtyre rregullave.

2. Nëse propozimi nuk përmbush kushtet, atëherë autoriteti kontraktues refuzon propozimin dhe informon propozuesin në lidhje me atë vendim.

3. Edhe kur propozimi i plotëson kushtet, autoriteti kontraktues mund të refuzojë propozimin nëse projekti është i panevojshëm. Vendimi do t'i komunikohet propozuesit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së propozimit.

4. Nëse propozimi i plotëson kushtet dhe autoriteti kontraktues nuk ka vendosur ta refuzojë atë, sipas pikës 3 të këtij neni, faza e dytë e vlerësimit paraprak do të jetë analiza e studimit paraprak, bazuar në informacionin e dhënë në propozimin e pakërkuar.

5. Autoriteti kontraktues vlerëson propozimin në mënyrë që të përcaktojë nëse:

a) objektivat e projektit janë të përcaktuar qartë dhe të arritshëm;

b) objektivat e projektit i shërbejnë interesit publik dhe përshtaten brenda prioritetëve strategjike të autoritetit kontraktues;

c) nuk ka pengesa ligjore ose kufizime për zbatimin e projektit dhe/ose për të hyrë në një kontratë koncesioni/PPP;

ç) projekti mund të zbatohet siç është planifikuar, duke përdorur teknologjitë e propozuara, dhe pa rreziqe të paarsyeshme teknike;

d) projekti duket të ketë qëndrueshmëri ekonomike;

dh) projekti duhet të jetë në gjendje të tërheqë garantuesit/mbështetësit financiarë, duke siguruar kthimin e fuqishëm dhe të arsyeshëm financiar;

e) niveli i propozuar i alokimit të riskut nga subjektet e sektorit publik dhe privat është racional dhe i arsyeshëm;

ë) mbështetja e duhur financiare mund të përshtatet brenda buxhetit të kufizuar dhe detyrimeve të tjera fiskale në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



6. Rezultatet e të dhënave paraprake materializohen në një studim paraprak. Periudha për përfundimin e studimit duhet të jetë jo më shumë se 90 ditë nga data e paraqitjes së propozimit. Gjatë kësaj periudhe autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacione shtesë nga propozuesi.

7. Bazuar në informacionin e shqyrtuar dhe rekomandimin e dhënë nga studimi paraprak, autoriteti kontraktues mund të vendosë:

a) të refuzojë propozimin dhe të heqë dorë nga zbatimi i projektit; ose

b) të pranojë propozimin dhe të fillojë hartimin e studimit të fizibilitetit.

8. Vendimi për ta refuzuar ose për ta pranuar propozimin do t'i komunikohet propozuesit brenda afatit kohor të parashikuar në paragrafin 6 të këtij neni.

9. Në rast refuzimi, autoriteti kontraktues kthen të gjithë dokumentacionin e paraqitur si propozim i pakërkuar.

Neni 13

Detajimi i studimit të fizibilitetit

1. Para marrjes së vendimit për investime, autoriteti kontraktues harton një studim fizibiliteti, në përputhje me këto rregulla.

2. Në rastin kur propozuesi ka dorëzuar një propozim që përmban jo vetëm informacione minimale e të nevojshme për vlerësimin paraprak, por edhe analizën e plotë teknike, ekonomike dhe financiare, ose në rastin kur propozuesi ka paraqitur një studim të fizibilitetit të zhvilluar plotësisht, autoriteti kontraktues mund të përdorë të gjitha ose një pjesë të informacionit për të hartuar studimin e fizibilitetit, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Pavarësisht se sa i detajuar është propozimi, autoriteti kontraktues verifikon me kujdes të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për kontekstin e analizës.

4. Projekti trajtohet si produkt i autoritetit kontraktor dhe rezultatet e studimit të fizibilitetit duhet të tregojnë se:

a) projekti është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe përmbush kërkesat dhe politikat e autoritetit kontraktor;

b) projekti është i realizueshëm në aspektin e

realizueshmërisë teknike, ekonomike dhe tregtare, duke përfshirë edhe përballueshmërinë dhe përshtatshmërinë financiare;

c) projekti nuk ka ndikim negativ social dhe mjedisor;

ç) dhënia e kontratës me koncesion/PPP është ekonomikisht më e favorshme se dhënia e saj me prokurim publik.

5. Autoriteti kontraktues i komunikon propozuesit nëse projekti mund të zbatohet apo jo, në bazë të rezultateve përfundimtare të studimit të fizibilitetit. Pranimi përfundimtar i projektit duhet të miratohet nga Ministria e Financave, nëse është e nevojshme sipas nenit 42 të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

6. Afati për përfundimin e studimit të fizibilitetit, në rastin e një propozimi të pakërkuar fillon nga data e dhënies së vendimit, siç parashikohet në pikën 8 të nenit 12, dhe është jo më shumë se:

a) katër muaj, në rastin kur propozuesi ka paraqitur një studim fizibiliteti të zhvilluar plotësisht;

b) gjashtë muaj, në rastin kur propozuesi nuk ka paraqitur një studim fizibiliteti të zhvilluar plotësisht, por ka dorëzuar të plotë analizën teknike, ekonomike dhe financiare;

c) dy vjet, në rastin kur propozuesi ka dorëzuar vetëm formën minimale të propozimit.

7. Në rast refuzimi, autoriteti kontraktues do të kthejë të gjithë dokumentacionin e paraqitur në propozimin e pakërkuar.

Neni 14

Propozimet e pakërkua në kontekstin e procesit të koncesionit/PPP-së

1. Nëse projekti pranohet, atëherë autoriteti kontraktues mund të nisë procedurën për dhënien e kontratës. Parimi bazë është se dhënia e kontratës duhet të bëhet përmes një procesi transparent dhe konkurrues në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

2. Para nisjes së procedurës së përzgjedhjes, propozuesit do t'i kërkohej të identifikojë në mënyrë specifike pronësinë intelektuale, që lidhet me zgjidhjet teknike ose teknologjitë e reja, të cilat ata duan të mbrojnë. Klasifikimi i gjithë dokumentacionit të propozimit si sekret, nuk është i pranueshëm.



3. Teknologjia “e re” duhet të ketë të paktën një prej karakteristikave të mëposhtme:

a) një proces, projektim, metodologji apo koncept inxhinierik të njohur, i cili ka demonstruar aftësinë e tij për të reduktuar ndjeshëm kostot e ndërtimit, për të përsheptuar realizimin e projektit, për të përmirësuar sigurinë, për të rritur performancën e projektit, për të zgjatur jetën ekonomike, për të zvogëluar shpenzimet e mirëmbajtjes dhe funksionimit të objekteve, ose për të zvogëluar ndikimin negativ mjedisor, problemet apo çrregullimet sociale/ekonomike si gjatë fazës së ndërtimit, ashtu edhe gjatë fazës së operimit të projektit;

b) një proces, për të cilin propozuesi i projektit ose cilido anëtar i sipërmarrjes së përbashkët/konsorciumit zotëron të drejta ekskluzive, qoftë në nivel botëror, qoftë në nivel rajonal; ose

c) një koncept, projektimi, metodologjik apo inxhinierik, për të cilën propozuesi ose një anëtar i konsorciumit propozues apo organizata, zotëron të drejtën e pronësisë intelektuale.

4. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në qoftë se propozuesi ofron me të vërtetë një koncept ose teknologji të re.

5. Dokumentet e tenderit nuk duhet të zbulojnë teknologjinë e veçantë dhe të re të përshkruar nga propozuesi në propozimin e pakërkuar. Në një rast të tillë, specifikimet teknike përcaktohen kryesisht në aspektin e performancës dhe/ose të kërkesave funksionale.

Neni 15

Shuma e rimbursimit

1. Kur procedura e dhënies së kontratës, e nisur në lidhje me propozimet e pakërkura, finalizohet me nënshkrimin e kontratës, propozuesi ka të drejtë të përfitojë kompensimin e shpenzimeve të bëra gjatë përgatitjes së propozimit të pakërkuar, nëse ai ka marrë pjesë si ofertues në procedurën e dhënies së kontratës, por nuk është shpallur fitues.

2. Shuma e rimbursimit mund të përcaktohet nëpërmjet vlerës së përllëgaritur të tregut për propozimin e projektit dhe duke marrë parasysh edhe karakteristikat e ndryshme të propozimit, të tilla si: dobia, korrektësia, saktësia, niveli i detajimit e të tjera.

3. Shuma e rimbursimit nuk do të jetë më e ulët

se 0,5% ose më të lartë se 2% të vlerës së koncesionit/PPP-së, në përputhje me kriteret treguese të mëposhtme:

a) 0,5% - 0,75%, nëse propozuesi i ka dorëzuar propozimin e pakërkuar në një formë minimale;

b) 0,75% - 1,5%, nëse propozuesi ka dorëzuar analizën gjithëpërfshirëse teknike, ekonomike dhe financiare;

c) 1,5% - 2%, nëse propozuesi ka paraqitur një studim të plotë fizibiliteti.

4. Shuma e saktë përcaktohet nga autoriteti kontraktues mbi bazën e propozimit të propozuesit, i cili në çdo rast duhet ta argumentojë propozimin e tij.

5. Nëse autoriteti kontraktues përcakton rimbursimin në shumë më të ulët se ajo e propozuar nga kërkuesi, ai duhet të argumentojë vendimin e tij.

Neni 16

Tarifa e koncesionit

1. Nëse është përcaktuar në studimin e fizibilitetit, koncesionari paguan një kompensim monetar për koncesionin në shumën dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratën e koncesionit.

2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga ministri i Financave për arkëtimin e të ardhurave për llogari të buxhetit të shtetit.

3. Shuma dhe afatet e pagesës së tarifës së koncesionit përcaktohen në përpjesëtim me objektin e koncesionit, me vlerën e parashikuar të kontratës së koncesionit, kohëzgjatjen e kontratës, risqet dhe kostot që koncesionari merr përsipër dhe fitimin e pritshëm, si dhe me nivelin e pajisjeve dhe vlerën e pronës së dhënë, sipas kontratës së koncesionit nga autoriteti kontraktues.

4. Kontrata e koncesionit mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e shumës dhe/ose mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së tarifës së koncesionit brenda një periudhe kohore të caktuar, gjatë të gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe me vendimin për dhënien e kontratës.

5. Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore.



KREU IV
PROCEDURA DHE KRITERET PËR
VLERËSIMIN DHE MIRATIMIN E
PROJEKTEVE TË
KONCESIONEVE/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT QË KËRKOJNË
MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 17

**Miratimi para shpalljes së procedurës së
dhënies me koncesion/PPP**

1. Projektet e koncesione/PPP-ve dorëzohen në Ministrinë e Financave për miratim, pavarësisht modelit të parashikuar të koncesionit/PPP-së dhe mënyrës, në të cilën ato janë nisur, domethënë si propozim i kërkuar apo i pakërkuar.

2. Autoriteti kontraktues kërkon miratimin sipas pikës 1 të këtij neni, përpara shpalljes së procedurës për dhënien me koncesion/PPP të një kontrate.

3. Përveç miratimit të përshkruar në pikën 2 të këtij neni, duhet të miratohen nga Ministria e Financave edhe projektet e koncesioneve/PPP-ve që pësojnë ndryshime të kontratës apo transferim të saj, në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat, kur ndryshimet ose transferimet ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, buxhetin e shtetit ose ndryshojnë në çfarëdo mënyre mbështetjen financiare.

Neni 18

Procedura

1. Kërkesa për miratimin e ministrit të Financave paraqitet në formë të shkruar dhe shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 19 të këtyre rregullave.

2. Ministri i Financave analizon dhe vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e marrë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këto rregulla.

3. Ministri i Financave nxjerr vendimin për miratimin ose refuzimin e projektit jo më vonë se 45 ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, nëse autoriteti kontraktues nuk ka marrë ndonjë kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit. Në rast se autoriteti kontraktues ka marrë një kërkesë të tillë, atëherë afati zgjatet 15 ditë nga dita kur është marrë informacioni.

4. Kur një projekt është hartuar me ndihmën e

Njësisë së Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat ose të ekspertëve të jashtëm, atëherë ministri i Financave nëpërmjet autoritetit kontraktues mund të kërkojë nga subjektet në fjalë një mendim shtesë për çështje që kanë rëndësi për objektin e analizës që është nën autoritetin e ministrit të Financave.

5. Në rast se autoriteti kontraktues nuk e ka nisur procedurën për dhënien e kontratës së koncesionit/PPP-së, brenda 2 vitesh nga marrja e miratimit, projekti duhet të paraqitet përsëri për miratim.

6. Ministria e Financave publikon në faqen e saj të internetit emrat e projekteve të miratuara, jo më vonë se 20 ditë nga dita kur është bërë miratimi.

Neni 19

Dokumentacioni

1. Kërkesa për miratimin e ministrit të Financave shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) studimin e fizibilitetit dhe anekset shoqëruese, përfshirë një matricë të alokimit të riskut dhe Krahasuesin e Sektorit Publik (KSP) nëse janë të zbatueshme, si dhe projekt-kontratën, e cila përmban kushtet e përgjithshme dhe anekset shoqëruese nëse janë të zbatueshme;

Për aq sa studimi i fizibilitetit tashmë nuk i mbulon këto çështje, të dorëzohet edhe:

b) argumentimi me shkrim të vendimit për dhënien e projektit me koncesion/PPP;

c) një raport cilësor dhe/ose sasior mbi rreziqet që parashikohen të ndërmerren plotësisht ose pjesërisht nga partneri publik dhe një përshkrim të metodologjisë së vlerësimit sasior të riskut në masën që janë të zbatueshme, si dhe masat e parashikuara publikisht për zbutjen e riskut;

ç) përshkrimin e projektit të propozuar të koncesionit/PPP-së;

d) raportin që paraqet implikimet fiskale vjetore të drejtpërdrejta dhe/ose të pritshme të projektit gjatë kohëzgjatjes së kontratës, përfshirë një përshkrim të burimeve të financimit për shërbimin e detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në pagesat e tarifave vjetore të disponueshmërisë, si dhe garancitë;

e) raportin mbi përmbushjen e kushteve për trajtimin jashtë bilancit të projektit, nëse aplikohet;



2. Dokumentacioni shtesë që mund të dorëzohet nga autoriteti kontraktues me kërkesë të ministrit të Financave, nëse zbatohet dhe është në dispozicion, mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:

a) projektet/dokumentacionin/përshkrimet e kontratës;

b) kërkesat e subjektit për qëllime të veçanta në rastet e propozimeve të pakërkuara;

c) blerjen dhe transferimet e të drejtave të pronësisë, të pasurive, të drejtave pasurore apo të drejtave të tjera reale;

ç) standardet e shërbimit dhe të mirëmbajtjes;

d) mekanizmat e përlogaritjes së tarifës së disponueshmërisë;

dh) kërkesat në lidhje me sigurimet;

e) akte të tjera ligjore, kontratat apo dokumentacioni, nëse është e nevojshme.

3. Dokumentacioni i përcaktuar nga ky nen, dorëzohet një kopje në formë të shkruar dhe një kopje në formë elektronike (CD apo forma të ngjashme me të).

4. Pas marrjes së dokumentacionit të përcaktuar nga ky nen, ministri i Financave verifikon dokumentacionin dhe nëse vlerësohet i paplotë, kërkon plotësimin e tij.

Neni 20

Procedura e analizës

1. Ministri i Financave:

a) përcakton ndikimet e menjëhershme dhe të mundshme fiskale për qëllimet e vlerësimit të përballueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre, si dhe për qëllime të buxhetimit të detyrimeve dhe angazhimeve të tilla, kur është e përshtatshme;

b) përcakton përballueshmërinë fiskale, në lidhje me pajtueshmërinë e mbështetjes së parashikuar financiare (alokimet buxhetore), duke përfshirë risqet, me tavanet e buxhetit/borxhit të përcaktuara nga rregullat e buxhetit;

c) përcakton qëndrueshmërinë dhe fizibilitetin fiskal, në lidhje me projeksionet afatgjata (fluksin e parasë) dhe parashikimet (makroekonomike) të kapacitetit buxhetor dhe aftësinë për të përkrahur shërbimin e mbështetjes financiare dhe angazhimet e tjera kontraktuale të parashikuara nga projekti;

d) analizon risqet, kryesisht ato që merren përsipër plotësisht ose pjesërisht nga autoriteti

kontraktues, për qëllimin e vlerësimit të probabilitetit të ndodhjes së tyre dhe të kostove, si dhe në lidhje me përmbushjen e kërkesave për trajtim jashtë bilancit, nëse është e përshtatshme.

2. Për kryerjen e detyrave të përshkruara në paragrafin 1, Ministria e Financave merr parasysh sa më shumë që të jetë e mundur raportet e përshkruara në paragrafin 1 të nenit 18 të këtyre rregullave.

3. Ministri i Financave, gjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, mban në konsideratë kufirin maksimal të totalit të detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në pagesat e tarifave të disponueshmërisë së partneritetit publik privat, që mund të vendosen në nivel lokal dhe qendror.

4. Të gjitha çështjet e tjera që lidhen me trajtimin kontabël të koncesioneve/PPP-ve dhe buxhetimit për projektet e koncesioneve/PPP-ve, rregullohen sipas legjislacionit përkatës.

Neni 21

Veprimet e ministrit të Financave

1. Ministri i Financave me vendim:

a) miraton projektin, nëse shumica e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare janë të përballueshme dhe të qëndrueshme;

b) kundërshton projektin, nëse shumica e parashikuar dhe mënyra e pagesës së mbështetjes financiare të projektit nuk janë të papërballueshme dhe/ose të paqëndrueshme.

2. Vendimi i përshkruar në pikën 1, duhet të jetë i argumentuar.

3. Në qoftë se ministri i Financave nuk e merr vendimin brenda afateve të përcaktuara sipas këtyre rregullave, atëherë projekti quhet i miratuar.

4. Projektet e refuzuara mund t'u nënshtrohen ndryshimeve të nevojshme dhe të paraqiten përsëri për miratim nga ministri i Financave.

Neni 22

Kërkesat buxhetore

1. Në bazë të tavanit të shpenzimeve për periudhën afatmesme të miratuar nga Këshilli i Ministrave, autoriteti kontraktues, gjatë hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme për institucionin përkatës, mban në konsideratë përfshirjen në këto kërkesa të kostos që lidhet me kontratat e partneritetit publik privat, që janë në proces



shqyrtimi dhe që parashikohet të miratohen në periudhën afatmesme respektive.

2. Autoriteti kontraktues përpara dërgimit për miratim nga ministri i Financave të një projekti për partneritetin publik privat që kërkon mbështetje financiare, duhet të garantojë që kostot përkatëse të projektit janë të planifikuara të përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuara nga Kuvendi, si dhe brenda taveaneve të shpenzimeve për periudhën afatmesme, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Miratimi i ndryshimeve ose i transferimeve të kontratës

1. Kur një ndryshim ose transferim i kontratës së koncesionit/PPP-së i ndërmarrë në kuptim të ligjit për koncesionet dhe partneritetin publik privat ndikon ose krijon riskun e ndikimit të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë mbi buxhetin e autoritetit kontraktues, buxhetin e shtetit ose që ndryshon në çfarëdo mënyrë mbështetjen financiare, atëherë një projekt i tillë i dorëzohet ministrit të Financave për miratim.

2. Autoriteti kontraktues paraqet me shkrim shkaqet e ndryshimit të propozuar dhe/ose të transferimit të kontratës, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

3. Përveç përshkrimit dhe dokumentacionit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, autoriteti kontraktues dorëzon, në masën e mundshme, raporte të përcaktuara nga pikat “c” dhe “d” të pikës 1 të nenit 19 të këtyre rregullave, në lidhje me ndikimet që ndryshimet dhe/ose transferimi i kontratës kanë mbi projektin për pjesën e mbetur të kohëzgjatjes së tij.

4. Mbi bazën e analizës së kryer, ministri i Financave vendos nëse ndryshimet e propozuara dhe/ose transferimi i kontratës së koncesionit /PPP-së dëmtojnë në mënyrë të konsiderueshme përballueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e projektit, në kuptim të neneve 19 dhe 20 të këtyre rregullave.

5. Ministri i Financave jep miratimin jo më vonë se 20 ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë në bazë të pikës 2 të këtij neni, nëse nuk kërkon informacion shtesë nga autoriteti kontraktues. Në rast se kërkohet një informacion i tillë, atëherë afati zgjatet 15 ditë nga dita kur është marrë informacioni.

Faqe | 7992

KREU V SHPALLJA DHE ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 24

Miratimi i dokumenteve standarde dhe kontratës tip

Autoriteti kontraktues i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave setin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese dhe kontratën tip, për projekte koncesionare / PPP për dhënien me koncesion / partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve, për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale.

Neni 25

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive

1. Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm. Në rast të bashkimit të grupeve të operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktues duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

2. Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

3. Para dorëzimit të ofertës, grupi i operatorëve duhet të dorëzojnë zyrtarisht një kopje të marrëveshjes së konsorciumit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e saj, të noterizuar përpara një noteri, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

4. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.



5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi, nëse nuk kërkohet ndryshe në dokumentet e tenderit.

6. Çdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi, i marrë së bashku.

7. Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës dhe përpara shpalljes së ofertuesit fitues, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

Ndryshimet në përbërjen e bashkimit të operatorëve të kualifikuar janë të mundura vetëm nëse një veprim e tillë është lejuar në dispozitat përkatëse të dokumenteve standarde të tenderit, vetëm midis operatorëve pjesëmarrës në procedurën e parakualifikimit dhe në çdo rast përpara dorëzimit të ofertës ekonomike

8. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jopërfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Neni 26

Njoftimi i kontratës

1. Autoriteti kontraktues bën të njohur qëllimin e tij për të dhënë një kontratë me koncesion/PPP me anë të një njoftimi kontrate, e cila duhet të publikohet të paktën në njërin prej gazetave ndërkombëtare të njohura në tregun kapital e financiar dhe/ose në një publikim të specializuar ndërkombëtar në sektorin e infrastrukturës së

transportit, si dhe në dy gazeta të përditshme kombëtare.

2. Njoftimi i kontratës botohet në një formular standard, i cili duhet të përmbajë minimalisht:

- a) emrin dhe adresën e autoritetit kontraktues;
- b) emrin dhe adresën e personit përgjegjës;
- c) llojin e autoritetit kontraktues;
- d) objektin dhe llojin e kontratës;
- e) kohëzgjatjen e kontratës;
- f) vendndodhjen e objektit të kontratës;
- g) informacionin ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik;
- h) kriteret e përzgjedhjes së fituesit;
- i) afatin kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;
- j) afatin kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;
- k) periudhën e vlefshmërisë së ofertave;
- l) informacione plotësuese.

3. Njoftimi i kontratës është pjesë e dokumenteve standarde të koncesioneve/PPP-ve, dhe publikohet në formën elektronike në sistemin elektronik të prokurimit dhe në Buletinin e Prokurimit Publik.

Neni 27

Dokumentet për procedurën e tenderit

1. Autoriteti kontraktues do të ngrejë njësinë përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të procedurës së tenderit. Elementet teknike dhe specifikimet e procedurës së tenderit do të përgatiten nga strukturat brenda autoritetit kontraktues të cilat janë të specializuara në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, ose nga ekspertë të jashtëm në rastet kur autoriteti kontraktues nuk e ka kapacitetin e nevojshëm për këtë qëllim. Në rastin e kontratave komplekse ose të kontratave që kërkojnë njohuri të veçanta teknike apo ligjore, autoriteti kontraktues mund të përfshijë ekspertë të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe/ose konsulentë të jashtëm për të ndihmuar me hartimin e dokumenteve të procedurës së tenderit.

2. Dokumentet e procedurës së tenderit përfshijnë kërkesën për kualifikim, kërkesën për propozimet dhe kontratën e koncesionit me programet përkatëse. Dokumentet e procedurës së tenderit do të përfshijnë informacion të përgjithshëm dhe specifik që lidhet me qëllimin e projektit.



3. Informacioni i përgjithshëm do të përfshijë minimalisht:

- a) udhëzimet për kandidatët/tenderuesit;
- b) formularin e aplikimit për tenderin;
- c) kriteret e kualifikimit/pjesëmarrjes;
- d) formularin e sigurimit të tenderit;
- e) formularin e sigurimit të kontratës;
- f) formularin e njoftimit të ofertuesit fitues;
- g) formularin e skualifikimit të ofertuesit/kandidatit;
- h) formularin e ankimimit të ofertuesit/kandidatit.

4. Informacioni specifik do të përfshijë minimalisht:

- a) përshkrimin e projektit dhe specifikimet teknike përkatëse;
- b) kërkesat specifike për kualifikimin dhe dhënien e ofertës;
- c) projektet me koncesion, kontratën e koncesionit me gjithë afatet përkatëse.

5. Udhëzimet për ofertuesit do të përshkruhen në kërkesën për kualifikim dhe kërkesën për propozim dhe do të përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e ofertës. Udhëzimet do të hartohen në përputhje me parimet e transparencës dhe trajtimit e drejtë, duke u siguruar që të gjithë ofertuesit të trajtohen njësoj në lidhje me vizitat në terren, pjesëmarrjen në konferencat e ofertuesve, kërkesat për sqarime në lidhje me dokumentet e procedurës së tenderit, procedurën e tenderit dhe kontratën e koncesionit, dhe të gjitha aspektet e tjera të projektit. Autoriteti kontraktues do të dërgojë përgjigjet e kërkesave për sqarim të të gjithë ofertuesit të cilët kanë kërkuar dokumentet e procedurës së tenderit në rastin e procedurës së tenderit vetëm me një fazë, dhe të të gjithë tenderuesit e parakualifikuar në rastin e procedurës së tenderit me dy faza, pa asnjë përjashtim. Çdo ndryshim apo modifikim në procedurën e tenderit ose në dokumentet e procedurës së tenderit duhet t'i bëhet e ditur të gjithë ofertuesve që kanë kërkuar dokumentet e procedurës së tenderit në rastin e procedurës së tenderit me një fazë, dhe gjithë ofertuesve të parakualifikuar në rastin e procedurës së tenderit me dy faza, pa asnjë përjashtim. Udhëzimet do të japin informacion për rregullat e kontrollit të procedurës së tenderit dhe për dorëzimin e ankimimeve.

6. Formulari i aplikimit për tender do të kërkojë që çdo ofertues të konfirmojë që:

- a) ka studiuar dhe pranuar përmbajtjen e dokumenteve të procedurës së tenderit;
- b) ka autorizuar autoritetin kontraktues që të verifikojë informacionin/dokumentet bashkëngjitur ofertës së tij;

c) zotohet të zbatojë kontratën e koncesionit në përputhje me kërkesat e procedurës së tenderit, specifikimet teknike dhe termat e propozuar në ofertën e vet.

7. Sigurimi i ofertës do të ketë formën e një depozite apo garancie të dhënë nga një bankë apo institucion financiar të licencuar sipas rregullave e ligjeve në fuqi për të ushtruar këtë aktivitet. Vlera e sigurimit të ofertës, termat e tij të vlefshmërisë, si dhe rrethanat në të cilat kërkohet sigurimi i ofertës do të specifikohen nga autoriteti kontraktues në dokumentet e procedurës së tenderit.

8. Para hyrjes në fuqi të kontratës së koncesionit, ofertuesi fitues do t'i dorëzojë autoritetit kontraktues sigurimin e kontratës. Nëse ofertuesi fitues nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftimin dhënë ofertuesit të preferuar, atëherë autoriteti kontraktues ka të drejtën të kërkojë sigurimin e ofertës dhe t'ia japë kontratën ofertuesit oferta e të cilit është klasifikuar e dyta. Vlera e sigurimit të kontratës, termat e vlefshmërisë, si dhe rrethanat në të cilat kërkohet sigurimi i kontratës do të specifikohen nga autoriteti kontraktues në kontratën e koncesionit dhe në dokumentet standarde të koncesionit / PPP.

9. Autoriteti kontraktues do t'i dërgojë ofertuesit fitues formularin e njoftimit për ofertuesit fitues, ku e informon që oferta e tij është pranuar dhe që negociatat për finalizimin e kontratës së koncesionit duhet të fillojnë. Ky njoftim duhet të dërgohet gjithashtu për botim në Buletin e Njoftimeve Publike. Njoftimi duhet të përmbajë: referencën për procedurën e tenderit; emrin dhe adresën e saktë të ofertuesit fitues; përshkrimin e projektit ose shërbimit të dhënë me koncesion; kohëzgjatjen e kontratës; vlerën e punimeve dhe/ose shërbimeve që do të sigurohen; emrat e ofertuesve të tjerë të cilët kanë dorëzuar oferta sipas kriterëve dhe vlerat financiare të ofertave të tyre; dhe emrat e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit të tyre.



10. Formulari i skualifikimit të ofertuesit do të specifikojë rrethanat në të cilat një ofertues skualifikohet nga procedura e tenderit. Autoriteti kontraktues do t'i kthejë ofertuesve të skualifikuar sigurimin e ofertës me përjashtim të rasteve kur ofertuesi skualifikohet si rezultat i përpjekjes së qëllimshme për të keqoriuentuar e mashtruar autoritetin kontraktues.

11. Formulari i ankimimit të ofertuesit do të përdoret nga ofertuesit të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ankimime administrative kundër veprimeve apo mosveprimeve të autoritetit kontraktues. Formulari duhet të përmbajë udhëzimet se si të arkivohet një ankimim, duke përfshirë identitetin e ankimesit, informacionin për procedurën e tenderit, përshkrimin e ankimimit, dhe arsyet për kundërshtimin e veprimeve apo të mosveprimeve të autoritetit kontraktues.

Neni 28

Kualifikimi i ofertuesit

1. Autoriteti kontraktues do të drejtojë parakualifikimin e ofertuesve në një ose dy faza. Mënyra e procedurës së parakualifikimit do të vendoset nga autoriteti kontraktues bazuar në karakteristikat e secilit projekt dhe do të specifikohen në kërkesën për dokumentin e kualifikimit.

2. Në lidhje me përvojën e ofertuesit, autoriteti kontraktues do të parakualifikojë vetëm ata ofertues të cilët minimalisht sigurojnë:

a) Prova që kanë kryer punë dhe/ose shërbime në projekte të ngjashme me koncesion/PPP të cilat janë zbatuar ose janë finalizuar me sukses, duke përfshirë vlerën e punëve dhe/ose shërbimeve të tilla;

b) Kopje të kontratave dhe/ose certifikata të performancës së suksesshme të tyre, të lëshuara apo firmosura nga përfituesit e këtyre punimeve dhe/ose shërbimeve, duke përshkruar natyrën e projektit, vlerën e punimeve dhe/ose shërbimeve, dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm që mund të shërbejë si provë e përvojës së ofertuesit;

c) Kopje të vlefshme formalisht të pasqyrave financiare të audituara të ofertuesit, duke përfshirë bilancin, pasqyrën humbje-fitim dhe pasqyrën e rrjedhës së pasasë.

3. Në rastin e një procedure tenderi me dy faza vetëm ata ofertues ofertat e të cilëve gjykohet se

kanë përmbushur të gjitha kërkesat për parakualifikim, do të lejohen të marrin pjesë në fazën e dytë të procedurës së tenderit.

Neni 29

Paraqitja dhe dorëzimi i ofertave

1. Paraqitja e ofertave:

a) Ofertuesit do të dorëzojnë ofertat e tyre në përputhje me udhëzimet dhe kushtet e parashtruara në kërkesën për propozime;

b) çdo ofertues do të dorëzojë vetëm një ofertë;

c) çdo ofertë duhet të përfshijë sa më poshtë:

i) pranimin nga ofertuesi të termave të parashtruar në kërkesën për propozime;

ii) pranimin nga ofertuesi të detyrimeve që rrjedhin nga dhënia e koncesionit/PPP.

d) të gjitha shpenzimet e ofertuesve gjatë gjithë përgatitjes së ofertave duhet të mbulohen nga ata vetë dhe nuk do të rimbursohen nga shteti.

2. Dorëzimi i ofertave:

a) Ofertat do të dorëzohen tek autoriteti kontraktues në mënyrën dhe në adresën e specifikuar nga autoriteti kontraktues në kërkesën për propozime. Mosparaqitja e ofertës sipas specifikimeve, ose mungesa e çdo elementi që kërkohet për paraqitjen e saj, e bëjnë të pavlefshme ofertën, rast në të cilin oferta skualifikohet dhe i kthehet ofertuesit.

b) Ofertat duhet të dorëzohen para afatit që tregohet në kërkesën për propozime si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati nuk do të merren në konsideratë dhe do t'i kthehen të pahapura ofertuesit.

Neni 30

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të emërohet me urdhër të kreut të autoritetit kontraktues dhe do të përbëhet nga ekspertë të autoritetit kontraktues, Autoritetit Shqiptar për Rrugët, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ose ministri dhe agjenci të tjera të përshtatshme. Numri i anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është tek, por nuk mund të kalojë 9 (nëntë) anëtarë. Komisioni do të jetë përgjegjës, zhvillimin e procesit të tenderit, dhe vlerësimin e ofertave. Kreu i Komisionit do të përzgjidhet nga anëtarët e lartë të Autoritetit Kontraktues dhe do të jetë përgjegjës për punën e vet.



2. Personat të cilët kanë konflikt interesi me ndonjë nga ofertuesit sipas ligjit për konfliktin e interesit nuk do të lejohen të jenë pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. Çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të konfirmojë që ai/ajo nuk ka lidhje gjaku apo martesore apo që nuk ka interesa tek asnjë nga ofertuesit që marrin pjesë në procedurën e tenderit.

4. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave do të detyrohen të mbajnë konfidenciale të gjitha aspektet përkatëse të procedurave të tenderit.

Neni 31

Hapja dhe vlerësimi i ofertave

1. Hapja e ofertave do jetë publike dhe do të bëhet si më poshtë:

a) Përfaqësuesit e ofertuesve do ftohen të marrin pjesë në procedurën e hapjes.

b) Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shpallë emrat e ofertuesve, ofertat e të cilëve janë dorëzuar para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave.

c) Në rastin e procedurës së tenderit me një fazë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të hapë dokumentet e parakualifikimit të çdo ofertuesi dhe do të shpallë listën e dokumenteve që ka dorëzuar. Më pas, Komisioni do të vazhdojë me vlerësimin e dokumenteve të parakualifikimit me dyer të mbyllura dhe do të shpallë rezultatet brenda 60 ditëve.

d) Pas shpalljes së ofertuesve të parakualifikuar në rastin e procedurës së tenderit me një fazë, ose gjatë procedurës së hapjes së ofertave në rastin e procedurës së tenderit me dy faza, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të hapë çdo ofertë dhe do të shpallë nëse përmban oferta teknike, ligjore dhe financiare, sipas rastit. Më pas, Komisioni vazhdon me vlerësimin e ofertave me dyer të mbyllura.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka të drejtën t'i kërkojë sqarime ofertuesit për ato elemente të ofertave të tyre që u duken të paqarta. Kërkesat për sqarime dhe sqarimet e ofertuesve do të jepen me shkrim dhe do të pasqyrohen në procesverbalin e takimeve të Komisionit.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të ketë afat deri në 60 ditë për të vlerësuar ofertat dhe do

të bëjë vlerësimin në përputhje me rregullat e specifikuar në kërkesën për propozime. Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, Komisioni do të përgatisë renditjen përfundimtare të ofertuesve. Në rastin kur ka vetëm një ofertues që i plotëson të gjitha kriteret, Komisioni ka të drejtë të vendosë për ta pranuar apo refuzuar atë ofertë. Në rastin kur ka dy ose më shumë oferta me të njëjtin rezultat/renditje më të ulët, këta ofertues do t'u kërkohej të dorëzojnë Ofertën Finale dhe Më të Mirë (OFMM). Rregullat për dorëzimin e OFMM do të specifikohen në kërkesën për propozime.

4. Pas mbylljes së periudhës së vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda 15 ditëve do të përgatisë një raport për procedurën e vlerësimit dhe do t'i rekomandojë kreut të Autoritetit Kontraktues një ofertues fitues. Një raport i tillë do të përmbajë minimalisht:

a) objektin e koncesionit;

b) përmbledhjen e procedurës së tenderit;

c) numrin e ofertave të dorëzuara dhe një përmbledhje të çdo oferte;

d) kriteret e vlerësimit të ofertave dhe vlerësimin e bërë në bazë të këtyre kriterëve për çdo ofertë;

e) kriteret për përcaktimin e ofertës financiare;

f) klasifikimi i ofertuesve sipas vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

g) ankimimet, sipas rastit.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të publikojë në faqen e vet të internetit emrin e ofertuesit fitues, renditjen e ofertuesve dhe raportin e vlerësimit.

3. Pa mbylljes së periudhës për dorëzimin e ankimeve nga ofertuesit, autoriteti kontraktues do të ftojë ofertuesin fitues për të filluar negociatat finale me qëllim që të firmosë kontratën e koncesionit.

Neni 32

Procedura e ankimit

1. Një ofertues ka të drejtë të kërkojë një rishikim administrativ të procesit të vlerësimit të ofertave nëse mendon se një veprim i ndërmarrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave apo autoriteti kontraktues është në kundërshtim me dispozitat e këtij vendimi.

2. Një ofertues ka të drejtën të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 5 ditëve kalendarike nga data e publikimit të ofertuesit



fitues dhe të renditjes së ofertuesve nga autoriteti kontraktues.

3. Çdo ankimim në Komisionin e Prokurimit Publik do të bëhet në formën e duhur duke treguar emrin dhe adresën e pretenduesit, referencën e procedurës përkatëse, bazën ligjore dhe një përshkrim të shkëljes.

4. Çdo ankimim do të shoqërohet me një pagesë paraprake prej 10% të vlerës së sigurimit të ofertës. Në rastin kur kjo pagesë paraprake nuk kryhet, Komisioni i Prokurimit Publik mund të refuzojë të fillojë investigimin administrative. Pagesa paraprake do t'i kthehet pretenduesit nëse ankimimi pranohet. Nëse ankimimi nuk është i suksesshëm, pagesa paraprake do të mbahet nga qeveria e Shqipërisë në llogari të buxhetit të shtetit.

5. Pas marrjes së ankimimit, Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë një vendim për ta pezulluar ose jo procedurën e tenderit me qëllim që të fillohen procedurat e investigimit administrativ dhe do të njoftojë autoritetin kontraktues brenda 7 ditëve kalendarike.

6. Komisioni i Prokurimit Publik nuk do të pezullojë procedurën e tenderit nëse:

- a) shqyrtimi paraprak i ankimimit vendos që nuk është i rregullt nga ana ligjore; ose
- b) pezullimi është kundër interesit publik.

7. Para hyrjes në fazën e kontratës me koncesion, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të:

a) shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht vendimet apo aktet e autoritetit kontraktues;

b) urdhërojë autoritetin kontraktues që të rregullojë shkeljet përpara se të vazhdohet më tej me procedurën e tenderit.

8. Komisioni i Prokurimit Publik do të marrë vendimin brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e ankimimit dhe do të njoftojë pretenduesin dhe autoritetin kontraktues për vendimin. Pretenduesi ka të drejtë të apelojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik mbi baza administrative në një gjykatë kompetente brenda 30 ditëve kalendarike nga shpallja e vendimit. Procedura e tenderit nuk do të pezullohet gjatë kohës që apelimi shqyrtohet nga gjykata.

Neni 33

Pavlefshmëria e ofertës dhe dështimi i procedurës së tenderit

1. Një ofertë shpallet e pavlefshme kur një ofertues:

- a) nuk ka dhënë garancitë/sigurimin e nevojshëm;
- b) nuk ka përmbushur një nga kërkesat materiale të kërkesës për propozime;
- c) ka siguruar të dhëna false të një natyre materiale në ofertën e vet.

2. Procedura e tenderit do të konsiderohet jo e suksesshme, kur:

- a) asnjë nga ofertat e dorëzuara nuk i përmbush kërkesat e kërkesës për propozime;
- b) autoriteti kontraktues vendos që asnjë nga ofertat e dorëzuara nuk jep zgjidhje të pranueshme financiarisht apo teknikisht;
- c) Këshilli i Ministrave të Shqipërisë nuk miraton kontratën e koncesionit.

Neni 34

Dhënia e kontratës dhe bisedimet përfundimtare

1. Nuk do të ketë bisedime ndërmjet ofertuesit fitues dhe autoritetit kontraktues në lidhje me termat materiale të kontratës së koncesionit, me përjashtim të rasteve kur këta terma specifikohen nga autoriteti kontraktues si të negociueshëm në kërkesën për propozime para afatit përfundimtar të dorëzimit të kontratës.

2. Kontrata e koncesionit do të amendohet aq sa kërkohet, me qëllim që të: i) pasqyrojë amendimet e kërkuara për të bërë ndryshimet në nenin 33.1 më sipër; ii) mbushë të gjitha boshllëqet; iii) korrigjojë gabimet dhe mosveprimet.

3. Pas plotësimit të procedurës së vlerësimit dhe shpalljes së ofertuesit fitues, autoriteti kontraktues, me iniciativën e vet, do të përcaktojë një afat për ekzekutimin e kontratës së koncesionit.

4. Nëse autoriteti kontraktues vendos që bisedimet me ofertuesin e parë fitues nuk do të mbyllen me firmosjen e kontratës së koncesionit, ai ka të drejtën të ftojë për bisedime ofertuesin e renditur në vendin e dytë, dhe në rast se nuk arrin një marrëveshje me ofertuesin e klasifikuar në vendin e dytë, do të ftojë ofertuesin e renditur në vendin e tretë, e kështu me radhë. Autoriteti kontraktues ka të drejtë absolute të refuzojë



bisedimet me këdo apo të gjithë ofertuesit e mbetur, nëse prishen bisedimet me ofertuesin e parë fitues.

KËRKESË

Nr. 1128/6, datë 2.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (lotet 1 dhe 3, kulturat bujqësore dhe drufrutorë). Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “kultura bujqësore dhe drufrutorë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 15 103 371 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista e pasurive që shpronësohen nga ndërtimi i Segmentit Rrugor "Tiranë- Elbasan" (Loti I + Loti III)
Kulturat Bujqësore dhe Drufrutore (shesat)

Nr.	Emer Atësia Mbiemer	Nr. Pasurisë	Z.K.	Sip. (m2)	Kul.Bujq		Kul.Drufru		Totali Lek	Shënime
					Vlera Lek		Vlera Lek			
	Fshata Mjull Bathore, Komuna Farkë									
1	Bilal Begu	255/15	2704	825			66400		66400	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
2	Latif Begu	242/21	2704	1430			138200		138200	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
	Fshata Lunder, Komuna Farkë									
3	Qazim Bunaca	575/2	2704	1247			192293		192293	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
4	Qazim Bunaca	575/22	2704	755			140870		140870	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
5	Shyqyri Bernaca	575/12	2704	213			73860		73860	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
6	Gezim Ggori	578/7	2704	140			22110		22110	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
7	Shyqyri Bernaca	578/14	2704	1631			563150		563150	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
8	Lutfi Bernaca	578/12	2704	755			233500		233500	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
9	Bedri Bernaca	578/11	2704	1357			477210		477210	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
10	Durim Bernaca	578/10	2704	825			288070		288070	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
11	Hamit Bernaca	578/5	2704	2169			404850		404850	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
12	Bajram Bernaca	578/1	2704	571			200120		200120	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
13	Ramazan Bernaca	575/1/1	2704	194			30770		30770	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
14	Bajram Bernaca	575/3/1	2704	2502			365560		365560	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
15	Bajram Bunaca	575/4	2704	1165			113070		113070	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
16	Sefer Bernaca	575/21	2704	564			53960		53960	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
17	Bashkim Bernaca	575/19	2704	1400			134370		134370	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012



18	Shpetim Bernaca	575/17	2704	919		85540	85540	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
	Fshati Mullet, Komuna Petrelë							
19	Ismail Çeliku	22/10	2735	468		123460	123460	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
20	Petrit Burnaca	22/12	2735	2964		185900	185900	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
21	Syrja Dervishi	127/5	2735	4266		644965	644965	Per VKM (toka)
22	Syrja Dervishi	125/15	2735	2074		443310	443310	Per VKM (toka)
23	Selman Dervishi	125/13	2735	484		174160	174160	Per VKM (toka)
24	Selman Dervishi	127/4	2735	4710		960910	960910	Per VKM (toka)
	Fshati Dobresh, Komuna Berzhite							
25	Bajram Mali	426/18	1498	1514		201095	201095	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
	Fshati Berzhitë, Komuna Berzhitë							
26	Rukije Stafa	126/103	1170	597		164950	164950	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
27	Rukije Stafa	223/27	1170	235		810040	810040	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
28	Agim Gjuzi	222/37	1170	1050		179070	179070	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
29	Skënder Skalaj	222/38	1170	347		82450	82450	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
30	Ramzan Gjuzi	126/109	1170	710		211050	211050	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
31	Haxhi Sallaku	222/49	1170	894		195440	195440	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
32	Festim Stafa	126/132	1170	271		70080	70080	Per VKM
33	Ilir Hoxha	222/40	1170	396		288500	288500	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
34	Murat Gjuzi	222/36	1170	1442		83300	83300	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
35	Selim Basha	222/57	1170	391		105300	105300	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
36	Sabri Tarja	42/1	1170	1156		257350	257350	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
37	Xhemal Sallaku	222/27	1170	777		273825	273825	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
	Fshati Dobresh, Komuna Berzhitë							



38	Bajram Mali	426/18	1498	1514		479417	479417	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
39	Haxhi Sallaku	436/13	1498	122		84050	84050	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
	Fshati Ibë, Komuna Berzhitë							
40	Edmond Sejdarasi	44/31	1977	928		66900	66900	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
41	Ramazan Proga	44/64	1977	2656		198950	198950	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
42	Petrit Çoku	301/13	1977	288		73650	73650	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
43	Petrit Çoku	300	1977	650		99000	99000	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
44	Emin Kukli	120/1	1977	700		63050	63050	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
45	Emin Kukli	122/1	1977	1650		89200	89200	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
46	Genc Drita	44/13	1977	2338		421800	421800	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
47	Petrit Çoku	30	1977	518	54390	54390	54390	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
48	Besim Çoku	47/4	1977	400		154800	154800	VKM Nr. 545 dt 13.6.2013
	Fshati Mushqeta, Komuna Krabë							
49	Xhemal Lika	14/1	2752	1218		367000	367000	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
50	Maliq Karafili	4/2/11,	2752	3500		345381	345381	VKM Nr. 228 dt 29.2.2012
	Fshati Shëngjin, Komuna Gracen							
51	Myslym Bunga	382	3346	2100		75500	75500	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
51	Sherif Hasa	382/1	3346	822		16080	16080	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
51	Aqif Lleshi	370	3346	1370		26400	26400	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
51	Ramazan Haka	373/1	3346	713		126750	126750	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
	Fshati Shtëmaj, Komuna Bradashesh							
52	Arti Allhasa	111/21	3419	645		208780	208780	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014

[illegible]



72	Grigor Gega	16/4	3371	244		69800	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
73	Kostandin Preni	9/14	3371	654		71920	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
74	Bardhyl Terziu	11/43	3371	379		22000	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
75	Haxhi Barolli	17/7	3371	451		40000	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
76	Lena Gega	11/21.	3371	700		44000	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
77	Dhespina Ranxha	11/9.	3371	430	7740	7740	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
78	Vasil Gega	17/9.	3371	742	206000	307600	Kërkesa per Shpronësim në MTL. Nr.2442/5 dt 21.1.2014
					315130	14788241	15103371

**KËRKESË****Nr. 3842/5, datë 19.9.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Shkodër”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të

pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 20 505 849.7 (njëzet milionë e pesëqind e pesë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë pikë shtatë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista e pronareve që pronat e tyre preken nga ndërtimi i segmentit rrugor
"Unaza Lindore Shkodër" (truall)

Nr.	PRONARI			Zona Kad.	Numri Pas.	Lloji Pas.	Siperf. Përgjith. m ²	Truall		Shenime
	Emri	Atesia	Mbiemri					Sip.e Shpron. leke/m ² (m ²)	Çmimi Vlera, Leke	
1	Qemal	Hamza	Suma	8597	10/162	Truall	300	115	9337	Konfirmuar
2	Tonin	Martin	Shqau	8593	10/191	Truall	300	198	8208	Kualif.leg.VKM.nr.549 dt.7.07.2010
3	Paulin		Radovani	8593	8/294	Truall	5648	332	8208	Konfirmuar
	("Adelchi Shqiperia")									
4	Paulin		Radovani	8593	8/300	Truall	750	67	8208	Konfirmuar
5	Pjerrin	Gjon	Verri	8593	12/103	Truall	251.3	44.5	8208	Kualif.leg.VKM.nr.513 dt.1.08.2012
6	Tom	Lulash	Ndershtigaj	8593	12/101	Truall	300	60	8208	Kualif.leg.VKM.nr.549 dt.7.07.2010
7	Lulzim	Çun	Dedaj	8592	8/640	Truall	186.6	113	10849	Konfirmuar
8	Tonin	Mhill	Buxhaj	8592	8/639	Truall	162.9	86	10849	Konfirmuar
9	Zef	Ndok	Boka	8592	8/635	Truall	304.9	101	10849	Konfirmuar
10	Ali	Brahim	Burgaj	8592	12/283	Truall	308.6	14.7	10849	Konfirmuar
11	Arjan	Ragip	Zagani	8592	12/284	Truall	203.9	58	10849	Kualif.leg.VKM.nr.549 dt.7.07.2010
12	Trashegimtaret		Hallunaj	8592	12/155	Truall	640	11.5	10849	(Kufizuar)Konfirmuar
13	Safet, Sabahet Satber		Kopliku	8594	9/251	Truall	445	96.5	9002	Konfirmuar
14	Ipa identifikuar (pret.)(Tr.Hoxha,Paçrami)			8597	7/61	Truall	400	70.7	9337	Kufizuar
15	Bardhok	Marash	Demaj	8594	12/303	Truall	258.7	77	9002	Kualif.leg.VKM.nr.100 dt.27.01.2009
	Shuma							1444.9		13221825.7



Objektet qe shpronesohen si rezultat I ndertimit te segmentit rrugor
" Unaza Lindore Shkoder " (objekte)

Nr.	PRONARI				Numri Pasurise	EMERTIMI I OBJEKTIT		SHENIME
	Emri	Atesia	Mbiemri	Zona Kad.		Vlera ne leke sipas preventivit	Lloji objektit	
1	Bardhok	Marash	Demaj	8594	12/303	846127	Repart Pune	Kualif.Legaliz. V.K.M.Nr.100 dt.27.01.2009
2	Ali	Brahim	Burgaj	8592	12/283	3236685	Shtepi Banimi	Konfirmuar ZVRPP
3	Gezim	Viktor	Tusha	8592	8/643	626419	Repart Pune	Kualif.Legal. VKM.Nr.549 dt.07.07.2010
4	Xhavid	Hajdar	Hallunaj	8592	12/171	871999	Dyqan dhe porte	Kualif.Legal. VKM.Nr.549 dt.07.07.2010
5	Paulin		Radovani	8593	10/75(10/180)	1702794	Mure rrethues	Leje ndertimi
	SHUMA					7284024		

**KËRKESË****Nr. 3943/3, datë 2.10.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (shtesa). Subjekti kërkuar i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “arë, pemëtore, truall dhe banesë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 41 333 759.2 (dyzet e një milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë dy) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR TIRANË - ELBASAN (SHITESAT)
(NDRYSHIMET E PROJEKTTIT)

Nr.	PRONARI		NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			Kultura drufrutor e	Kultura bujqësore	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit	ZK				SIP (M2)	(LEK/M2)	Vlera(lekë)				
	Fshati Lunder Z.K.2704											
1	Hamit Isuf Bernaca	2704	578/5	Arë	5530	263	448	117824	97573		215397	Konfirmim ZVRPP
2	Gezim Xhemal Ggori	2704	578/7	Arë	3150	140	448	62720	14500		77220	Konfirmim ZVRPP
3	Ali Xhavit Teqja	2704	582/1	Arë	3000	858	448	384384	94500		478884	Konfirmim ZVRPP
4	Shtet	2704	582/2	Arë	20437	1092	448	489216			489216	Konfirmim ZVRPP
	Fshati Mullet Z.K.2735											
5	Shtet	2735	308	Arë	19400	738	448	330624			330624	Konfirmim ZVRPP
6	Qemal Nevruz Muka	2735	217/44	Arë	1000	341	448	152768			152768	Konfirmim ZVRPP
7	Shtet	2735	217/45	Arë	600	532	448	238336			238336	Konfirmim ZVRPP
8	Rustem Asllan Haxhiu	2735	217/28	Arë	6500	1021	448	457408			457408	Konfirmim ZVRPP
9	Hysni Asllan Haxhiu	2735	217/40	Arë	4000	153	448	68544		4435.2	72979.2	Pritet konfirmimi
10	Hysni Haxhiu	2735	217/41	Arë	3000	1458	448	653184		13851	667035	Pritet konfirmimi
	Fshati Mushqeta Z.K.2752											
11	Musa Ramazan Velia	2752	3/1,	Arë	3500	2792	297	829224	365885	17700	1212809	Konfirmim ZVRPP
12	Shyqyri Hajdar Velia	2752	3/7,	Arë	1000	1000	297	297000		6300	303300	Konfirmim ZVRPP
13	Ramazan Hysni Velia	2752	3/9,	Arë	3500	101	297	29997	85468		115465	Pritet konfirmimi
14	Zini Selman Rama	2752	3/10,	Arë	5000	1923	297	571131	339790		910921	Konfirmim ZVRPP
15	Kadife Abedin Rama	2752	3/2,	Arë	1500	233	297	69201	34715		103916	Pritet konfirmimi
16	Shtet	2752	26	Arë	600	600	297	178200			178200	Konfirmim ZVRPP
17	Ska informacion	2752	225	Arë		550	297	163350			163350	Konfirmim ZVRPP
18	Shtet	2752	25	Arë	900	900	297	267300			267300	Konfirmim ZVRPP
19	Tefik Selman Rama	2752	3/11,	Arë	6650	3315	297	984555	399980	21480	1406015	Konfirmim ZVRPP
20	Sulejman Zyber Velia	2752	3/3,	Arë	1600	1600	297	475200	382250	7590	865040	Konfirmim ZVRPP
21	Ismail Zyber Velia	2752	3/4,	Arë	2000	1925	297	571725	34580	19180	625485	Konfirmim ZVRPP



22	Shtet	2752	3/14,	Arë	130	130	297	38610	129912	6340	38610	38610	Konfirmim ZVRPP
23	Bashkim Ibrahim Velia	2752	3/13,	Arë	1010	1010	297	29970	129912	6340	29970	436222	Konfirmim ZVRPP
24	Defrim Ismail Haka	2752	3/6,	Arë	1500	822	297	244134	56850	3780	244134	304764	Konfirmim ZVRPP
25	Kujtim Ismail Haka	2752	3/12,	Pemitore	1500	1500	297	445500		14250	445500	459750	Pritet konfirmimi
26	Kujtim Ismail Haka	2752	27/18	Pemitore	1500	570	297	169290	12870		169290	182160	Pritet konfirmimi
27	I paidentifikuar	2752	27/24/3	Arë	4025	4025	297	1195425			1195425	1195425	Pritet konfirmimi
28	Shaqir Sulejman Velia	2752	27/15	Pemitore	1870	1870	297	555390	228965		555390	784355	Konfirmim ZVRPP
29	Bashkim Ibrahim Velia	2752	27/17	Pemitore	490	490	297	145530	78920		145530	224450	Konfirmim ZVRPP
30	Defrim Ismail Haka	2752	27/16	Pemitore	440	440	297	130680	48680		130680	179360	Konfirmim ZVRPP
31	Sheqere Hasan Velia	2752	27/13	Pemitore	1500	531	297	157707	96610		157707	254317	Pritet konfirmimi
32	I paidentifikuar	2752	27/24/1	Arë		5445	297	1617165			1617165	1617165	Pritet konfirmimi
33	Refik Nezir Velia	2752	27/14	Pemitore	2000	2000	297	594000	310190		594000	904190	Konfirmim ZVRPP
34	Ramazan Hysen Velia	2752	27/12	Pemitore	1000	670	297	198990	110940		198990	309930	Konfirmim ZVRPP
35	Shtet	2752	4/2/10,	Arë	237	237	297	70389			70389	70389	Konfirmim ZVRPP
36	Shygyri Hajdar Velia	2752	24	Arë	1000	1000	297	297000	163520		297000	460520	Konfirmim ZVRPP
37	Gani Maliq Karafili	2752	4/2/8,	Arë	5730	2165	297	643005	127840	14250	643005	785095	Konfirmim ZVRPP
38	Sherif ramazan Velia	2752	4/2/4,	Arë	2600	42	297	12474	39899		12474	52373	Konfirmim ZVRPP
39	Musa Ramazan Velia	2752	4/2/5,	Arë	5000	340	297	100980	70540		100980	171520	Konfirmim ZVRPP
40	Maliq Dino Karafili	2752	23	Arë	2430	1465	297	435105	323180		435105	758285	Konfirmim ZVRPP
41	Myftar Selman Velia	2752	21/7	Arë	5050	5050	297	1499850	217050		1499850	1716900	Konfirmim ZVRPP
42	Sinan Gjyshe Karafili	2752	21/1	Arë	1600	1600	297	475200	354894		475200	830094	Pritet konfirmimi
43	Skender Ali Ajazi	2752	21/4	Arë	1400	1400	297	415800	333340		415800	749140	Konfirmim ZVRPP
44	Fatmir Ibrahim Velia	2752	21/5	Arë	650	600	297	178200	393910		178200	572110	Konfirmim ZVRPP
45	Sheqere Hasan Velia	2752	21/6	Arë	960	251	297	74547	72255		74547	146802	Konfirmim ZVRPP
46	Sali Aydulla Ajazi	2752	21/8	Arë	1400	1177	297	349569	286670		349569	636239	Konfirmim ZVRPP
47	I paidentifikuar	2752	22/2	Arë	1730	1730	297	513810			513810	513810	Pritet konfirmimi
48	Arben Lika	2752	42/11	Pemitore	1300	378	297	112266	104330		112266	216596	Pritet konfirmimi
49	Shtet	2752	41	Arë	400	400	297	118800			118800	118800	Konfirmim ZVRPP
50	Mexhit Selman Lika	2752	42/10	Pemitore	1200	1045	297	310365	229220		310365	539585	Pritet konfirmimi
51	Ylli Musa Velia	2752	42/9	Pemitore	1400	1352	297	401544	238206		401544	639750	Pritet konfirmimi
52	Shtet	2752	20	Pemitore	2000	2000	297	594000			594000	594000	Konfirmim ZVRPP
53	Shtet	2752	43	Arë	900	900	297	267300			267300	267300	Konfirmim ZVRPP
54	Xhelal Ali Muharremi	2752	45/26	Arë	5000	2381	297	707157	646520		707157	1353677	Konfirmim ZVRPP
55	Shtet	2752	45/27	Arë	200	200	297	59400			59400	59400	Konfirmim ZVRPP
56	Figjiri Ymer Bafli	2752	45/30	Arë	2050	142	297	42174	33834		42174	76008	Konfirmim ZVRPP
57	Figjiri Ymer Bafli	2752	169	Arë					1068300			1068300	Me subvencion
58	Ymer Bafli	2752	46/2	Arë		1300	297	386100	359650		386100	745750	Pritet konfirmimi
59	Figjiri Ymer Bafli	2752	46/3	Arë	1800	1800	297	534600	629800		534600	1164400	Konfirmim ZVRPP
60	Shtet	2752	58/6	Ullishte	70	70	297	20790			20790	20790	Konfirmim ZVRPP
61	Hysen Selim Velia	2752	58/1	Arë	1050	610	297	181170	100448	3780	181170	285398	Konfirmim ZVRPP
62	Zyber Mustafa Tarja	2752	58/4	Ullishte	800	258	297	76626	38080		76626	114706	Konfirmim ZVRPP
63	Hysen Selim Velia	2752	57/4	Pemitore	380	310	297	92070	129650		92070	221720	Konfirmim ZVRPP
64	Fadi Selim Velia	2752	57/3	Arë	308	213	297	63261	209530		63261	272791	Konfirmim ZVRPP
65	Zyber Mustafa Tarja	2752	57/2/1	Tuall	300	106	324	34344	55632		34344	89976	Konfirmim ZVRPP



66	Ska informacion	2752	57/1	Pemitore	800	800	297	237600			237600	Konfirmim ZVRPP
67	Sali Tarja	2752	57/5	Truall	200	200	324	64800			64800	Priet konfirmimi
68	Shtet	2752	53	Arë	1400	1400	297	415800			415800	Konfirmim ZVRPP
69	Sali Mustafa Tarja	2752	51	Arë	1400	1400	297	188298	64348		252646	Konfirmim ZVRPP
70	Riza Ibrahim Tafa	2752	55	Pemitore	500	500	297	40392	45710		86102	Konfirmim ZVRPP
71	Riza Tafa	2752	52/1	Pemitore	1000	1000	297	79596	38000		117596	Priet konfirmimi
72	Shtet	2752	105	Arë	700	700	297	53757			53757	Konfirmim ZVRPP
73	Tahir Riza Tafa	2752	52/2/1	Truall	300	300	324	3888	55632		59520	Priet konfirmimi
	TOTALI					75191		23336309	9353166	132936.2	32822411.2	



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA E PRONAREVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË-ELBASAN" (OBJEKTET) SHITESA

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr.Pasurisë	Lloji i objektit	Sipërfaqe ndërtimi	Vlera (Lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Zeneli	2752	34/1/1	Banese 1 kt	130m2	5409523	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Tahir Riza Tafa	2752	52/2/1	Banese 1 kt	120m2	3101825	Certifikatë pronësie
	SHUMA TOTALE					8,511,348	

**KËRKESË****Nr. 4860/3, datë 2.10.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga Transballkanike” Vlorë. Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të

paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit, “truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 1 206 820 (një milion e dyqind e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

Lista për shpronësim pasuri Nr.33/128 në ZK.8605
segmenti "Rruga Transballkanike Vlorë"

Bashkia Vlorë

Nr.	PRONARI			Zona Kadast.	Nr. i pasurisë	Lloji Pasurisë	Sip. Totale (m2)	Sipërfaqe që Shpronësohet (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Krenar	Selam	Karafili	8604	33/128	Truall	975	145.4	8300	1,206,820	Konfirmim ZVRPP Hipotekohet favor Raiffeisen Bank.
	SHUMA									1,206,820	

**KËRKESË****Nr. 4451, datë 1.10.2014****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në lisën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Vlera totale e shpronësimit është 30 138 832 (tridhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh.

Lista

1. Zona kadastrale 8280 me nr.pasurie: 2/341, në pronësi të Endrit Alikaj.
2. Zona kadastrale 8280 ne nr.pasurie: 2/335, në pronësi të Ornella Mansaku.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro

**LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË SHPRONËSOHEN
PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK, TË CILAT
PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “NDËRHYRJE E PËRKOHSHME DHE
REHABILITUESE NË SHESHIN “NËNË TEREZA””**

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi lekë/m ²		Vlera/lekë			Shënime
				truall	ndërtim	truall	ndërtim	truall	ndërtësë	banesë	
1	Endrit Alikaj	8280	2/341	820.0	56.6	23,955,0	22,838,269	19,643,100	1,292,646		Sipas kartelës së pasurisë
2	Ornela Mansaku	8280	2/335	135.0	135.0	23,955,0	44,216,007	3,233,925	5,969,161		Sipas kartelës së pasurisë
				955	191,6			22,877,025	7,261,807		30,138,832
	TOTALI									Lekë	30,138,832

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 36 lekë